



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit
P- 93
Prishtinë, më 18 dhjetor 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 18 DHEJTOR 2009**

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 67 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në fillim të seancës, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, propozoi që pika e gjashtë e rendit të ditës - Shqyrtimi i propozim-vendimit për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale të hiqet nga rendi i ditës dhe t'i dërgohet Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport, Energjetikë dhe Telekomunikacion, për ta shqyrtuar, si komision funksional.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetrarit të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ... shumica absolute,
Kundër.....0,
Abstenime.....0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin e kryetrarit të Grupit Parlamentar të PDK-së për heqjen e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat antidamping,
5. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë së Privatizimit për periudhën gusht 2008- gusht 2009.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme

Kuvendi miratoi, pa vërejtje, procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 26 nëntor dhe me 4 dhjetor 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Nerxhivane Dauti, parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me e Projektligjin për letrat me vlerë për procedim dhe miratim në Kuvend.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

Deputetja, Suzan Novobrdaliu, parashtroi pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Valton Beqiri, lidhur me pagesën e të punësuarve në Ministrin e Kulturës që paguhën jashtë sistemit të rregullt të pagave.

Ministri Beqiri iu përgjigj pyetjes së deputetes Novobërdali.

Deputetja Qamile Morina, parashtroi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur me shpalljen e pandemisë së gripit AH1N1 nga OSHB-ja dhe krijimin një plani për menaxhimin e kësaj pandemie.

Ministri Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Morina.

Deputeti Dritan Tali, parashtroi pyetje për Kryeministrin, Zëvendëskryeministrin apo ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, lidhur me lansimin e fushatës ndërkombëtare mediale për përmirësimin e imazhit të shtetit të Kosovës.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti Naim Rustemi, parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me operatorin “Vala”, në tregun e telefonisë mobile në Shqipëri.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Rustemi.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj** tha se Projektligji për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë është paraparë me strategjinë legjislative për vitin 2009 të Qeverisë së Kosovës. Qëllimi i këtij projektligji është themelimi i një sistemi unik për klasifikimin dhe ruajtjen e informatave që kanë të bëjnë me interesat e sigurisë së Kosovës si dhe verifikimin e sigurisë së personave që kanë qasje në këto informata. Me këtë projektligj për herë të parë në Kosovë rregullohet në detaje klasifikimi i informatave dhe verifikimi i sigurisë në pajtim me kriteret e sigurisë të përcaktuara nga NATO, Bashkimi Evropian dhe standardet, konventat dhe detyrimet e zbatueshme ndërkombëtare.

Projektligji do të rregullojë mënyrën ligjore të klasifikimit të informatave dhe verifikimin e sigurisë dhe njëkohësisht do të zbatohet në mënyrë të përpiktë neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtim në parim të Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramadan Avdiu**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Suzan Novobrdaliu**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxherri**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Myfera Shinik**, si dhe deputetët: **Naim Maloku**, **Emrush Xhemajli** dhe **Adem Hajdari**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----69,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi; Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që Projektligjin ta shqyrtojnë brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat antidamping

Kryetari njoftoi deputetët se komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për masat antidamping dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, deputetja **Myzejene Selmani** tha se Komisioni Funksional ka shqyrtuar projektligjin, nen për nen, dhe ka hartuar amendamentet, që ia ka paraqitur Kuvendit për miratim. Ajo theksoi se gjatë radhitjes së amendamenteve ka ndodhur një gabim, pas amendamentit 44 fillon me amendamentin 46, ndërsa duhet të jetë amendamenti 45.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, ngriti disa probleme lidhur me amendamentin 3, që flet për ndryshimin e qëllimit të ligjit. Ai theksoi se Qeveria ka përkufizuar qëllimin e ligjit që është shumë i qartë dhe është në praktikën juridike dhe tani keni amendament ku është qëllimi i ligjit, ku ju kanë vendosur 5 paragrafë, gjithsej ka 200 rreshta e që është në kundërshtim me praktikën juridike. Çështja tjetër, neni 2 flet për përkufizimet, ndërsa në praktikën që i kemi për amendamentet duhet të jetë propozimi nga Projektligji dhe propozimi i amendamentit, dhe e konsideroj që komplet janë ndryshuar përkufizimet, jo në dobi, por në dëm të projektligjit. Ndërsa “Neni 3 i Projektligjit, zëvendësohet me nenin e ri 3”. Nuk ka mundësi për t’u zëvendësuar.

Ai paraqiti edhe disa vërejtje të tjera dhe propozoi që Projektligji të tërhiqet nga shqyrtimi i dytë, në mënyrë që Komisioni Funksional, në bashkëpunim me Departamentin Ligjor dhe propozuesin e Projektligjit t’i harmonizojë amendamentet e propozuara.

Në diskutim lidhur me amendamentet e propozuara diskutuan Armend Zemaj dhe Ardian Gjini.

Kryetari hodhi në votim propozimin për shqyrtimin e tretë të Projektligjit për masat antidamping.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----11,
Abstenime-----10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori

V E N D I M

1. Që Projektligji për masat antidamping të procedohet për shqyrtim të tretë.

2. Kërkohet nga Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që, në bashkëpunim me propozuesin e Projektligjit, t'i rishqyrtojnë amendamentet e propozuara në Projektligjin për masat antidamping dhe Kuvendit t'ia paraqesin Raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë së Privatizimit për periudhën gusht 2008 – gusht 2009

Kryetari i njoftoi deputetët se Agjencia Kosovare e Privatizimit ia ka parashtruar Kuvendit Raportin e punës për periudhën gusht 2008- gusht 2009. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe ka rekomanduar miratimin e tij në seancë plenare.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta marrë fjalën.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Naser Osmani**, tha se Komisioni rekomandon që Kryesia e Kuvendit të kërkojë nga Qeveria që sa më parë ta procedojnë Ligjin për Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme, me qëllim që të shqyrtohen të gjitha ankesat dhe paditë e kreditorëve dhe punëtorëve nga Oda e Veçantë, në kuptimin e asaj që të mundësohet puna në vazhdimësi e këtij institucioni, që ka të bëjë me raportimin e Agjencisë së Privatizimit.

Kryetari hapi debatin lidhur me Raportin e Agjencisë së Privatizimit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadergjona**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Behxhet Pacolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Qamile Morina**, në emër të Grupit Parlamentar "7+", **Xhezair Murati**, si dhe deputetët: **Edita Tahiri**, **Myzejene Selmani**, **Kaqusha Jashari**, **Heset Cakolli**, **Vezira Emrush**, **Mimoza Ahmetaj**, **Driton Tali**, **Naser Rugova**, **Naim Rrustemi** dhe **Myrvete Pantina**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari hodhi në votim Raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën gusht 2008 – gusht 2009. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për40,
Kundër.....14,
Abstenime.....10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën gusht 2008 – gusht 2009, me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:13 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**